

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

EMËRTIMI I PROJEKTIT:

FUNKSIONIMI I SPITALIT RAJONAL KORÇE

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar,
pika 12.2 “Spitalet”, Te gjitha instalimet

VENDODHJA:

QARKU KORÇE, RRETHI KORÇE, BASHKIA KORÇE

Kërkues:

“SPITALI RAJONAL KORÇE”



Hyrje.

Kjo permbledje e Raportit të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kerkese të subjektit "Drejtorse të Spitalit Rajonal Korçë". Ky subjekt, ka paraqitur kerkesen për hartimin e procedurës së konsultimit me publikun pranë AKM-së dhe do të aplikojë pranë QKB-së dhe AKM-së për tu pajisur me Leje Mjedisore të tipit B për aktivitetin Spitalor .

Aktiviteti zhvillohet në Bashkinë Korçë.

Raporti permbledhës i VNM-së ka për qëllim të informojë institucionet e mbrojtjes së mjedisit dhe personat ose organizatat e interesuara për cilësinë mjedisore në lidhje me mënyrën e funksionimit të aktivitetit të Spitalit rajonal Korçë si dhe masat e marra nga subjekti për reduktimin e ndotjes.

Projekti i Propozuar

Objekti i projektit të propozuar është funksionimi i Spitalit Rajonal Korçë pa krijuar problem për mjedisin dhe komunitetin .

Bazuar në shtojcat I dhe II Siptalet të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ky aktivitet nuk përshihet në listën e aktivitetëve që i nënshtrohen procedurës paraprake ose të thelluar të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, hartohet për të informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes së mjedisit mbi ndikimet në mjedis të aktivitetit.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor .

Bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", I ndryshuar, në Shtojcën I "Lejet e Mjedisit të tipave A, B dhe C në varesi të kapacitetit prodhues kufi" , ky projekt klasifikohet në **Veprimtari të tjera ID. 12.2. Spitalet**, pra në listën e aktivitetëve që duhet të pisen me Leje Mjedisore të tipit B për të gjitha instalimet.

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponentëve të veçante dhe të rëndësishëm të mjedisit nga faktore të ndryshëm, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore mund të përmendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".
- Ligj Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".
- Ligji Nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
- Ligj Nr. 37/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujorë pritëse"
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave".
- Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 "Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis".

- Vendim Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”.
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se VNM-se...”.
- Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”
- Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Proçedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.
- Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore”
- Udhezim Nr. 8, date 27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave”.

Krahas ketyre ligjeve dhe vendimeve nga ana e Parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme si:

- Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: “Për ratifikimin e konventes se Aarhusit” Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per çeshtjet e mjedisit.
- Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos” ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).
- Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor”.
- Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit” Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.
- Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve”.
- Vendim Nr.798, datë 29.9.2010 ”Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore”
- Rregullore Nr.6, date 30.11.2007”Per administrimin e mbetjeve spitalore”

Disa te dhena per spitalin

Spitali Rajonal i Korçes ndodhet ne qytetin e Korçes , Zona Kadastrale 8562 , me numur pasurie 3/250 dhe 3/251, Indeksi hartes KO-O-10. Ai kufizohet:

Spitali Rajonal Korçe është ndërtuar vite me pare. **Siperfaqja truall** eshte 19390+7367m² dhe **siperfaqe ndertimi** 5305+1531m².

Ne spitalin Rajonal Korce ndodhen keto godian: Godina pediatrie, Korpusi Kryesor, Godina Sanatoriumit, Godina Maternitetit, Farmacia dhe banka e gjakut.

Numuri i shtreterve total eshte 510 i ndare sipas sektoreve dhe sherbimeve.

Struktura analitike e shërbimit spitalor Rajonal Korçë është e përbërë 563 punonjës ku përfshihen:

Drejtoria, Sektori Finances, Sektori Kostos, Sektori Planifikimeve dhe Prokurorimeve, Sektori Burimeve Njerezore, Sektori i Menaxhimit të Teknologjise, Sektori Teknik, Sektori Hotelërise, Sektori i Shërbimeve Mjedisore(ndodhen në godinën e pediatrie)

Shërbim Spitalor përfshin: Shërbimin e Mjekësisë së Përgjithshme, Klinikën e Semundjeve Infektive, Shërbimin e Kardiologjise, Shërbimin e Kirurgjise, Puntin e Kujdesit Palliative, Salla e Operacionit, Klinikën e ORL- Okulistike, Shërbimin Anestezi-Reanimacion, Shërbimin e Pediatrie,-Klinika e Pediatrie së Përgjithshme, Klinika e Pediatrie Infektive(ndodhen në korpusin kryesor); Shërbimin Obstetrike- Gjinekologjise(Klinika e Obstetrikes, Klinika e Gjinekologjise, Salla e Operacionit, Klinika e Neonatologjise)(ndodhen në godinën e maternitetit); , Shërbimi i Pranim Urgjences(ndodhet në korpusin kryesor), Shërbimi i Neuro-Psikiatrikes(ndodhet në godinën e pediatrie kati 2), Shërbimi i Pneumofiziatrie dhe Dispanceria Anti TB, Dispanceria,(ndodhet në godinën e sanatoriumit); Farmacia, Sektori Psiko-Social(ndodhet në poliklinike);, Laboratori Klinik Biokimik(ndodhet në korpusin kryesor), Laboratori i Anatomisë Patologjike(eshtë i veçantë), Laboratori Mikrobiologjik, Shërbimi i Imazherise(ndodhet në korpusin kryesor), Banka e gjakut(se bashku me farmacinë), Kabineti i Fizioterapiae(ndodhet në korpusin kryesor), Shërbimi i Poliklinikes(eshtë godinë e veçantë), Kabineti i Onkologjise(ndodhet në korpusin kryesor).





INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Objekti ndodhet pothuajese ne periferi te qytetit te Korces, ne territorin administrativ te Bashkise Korçe. Ky aktivitet ndodhet ne zone urbane, me objekte te ngritura kohe me pare dhe nuk cenon siperfaqe toke me mbulesa bimore. Objekti ka akses me rrugen kryesore te qytetit. Relievi eshte fushor me pjerresi qe varion nga 0-0,5%. Bimesia e zones eshte kryesisht barishtore, por ka edhe peme, kryesisht ne oborret e banesave , objekteve te biznesit te ndertuara ne zone, dhe siperfaqes se qytetit te cilat kryesisht jane mbjelle nga vete pronaret dhe Bashkia. Siperfaqja qe eshte zene nga objekti ne funksion te ketij aktiviteti nuk ben pjese ne siperfaqet pyjore te rajonit dhe nuk ka demtuar bimesine. Efekti me i madh dhe i

rendesishem i ndertimeve te gjithë fushave pergjate rrugëve nacionale ka qene zenia e tokes bujqesore dhe tjetersimi i saj ne truall ndertimi, ndersa ne qytet problemet jane te karakterit individual dhe jane te kontrolluara nega bashkia..

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull.

Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Lagunat Bregdetare

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishtili me mustaqe dhe Thëllëza e Malit). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaçurel,

Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë.

Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Ndërkombëtare për

shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronjës uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tyelet e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës. Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25 vjetët e fundit. Meqënëse kjo shpellë është bërë më e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlish për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne sipërfaqen e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të identifikuar, por në rajonin e Korçës ndodhen disa burime ujore. Nder ta mund të përmendim burimi më i madh ujqor më i afert janë liqenet e Prespës dhe ai i Pogradecit, ndërsa përseja i perkete lumenjve përmendim deget e Lumit Devoll si ai i Lozhanit, etj. Në afërsi të objektit e kapanonit nuk ka burime ujore të identifikuar.

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujqit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive.

Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive.


Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante nga MM. Sic shihet edhe ne hartën e mëposhteme, zona ne vlerësim ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zonat e mbrojtura te rajonit. Ne rajonin e Korçes, zona e mbrojtur me e afert me projektin ne vlerësim eshte “Parku Kombetar i Prespes” rreth 15 km larg objektit dhe zona e “Liqenit te Pogradecit” rreth 30km larg objektit.

Monumentet Natyrore te Rrethit Korçe(Sipas VKM 676)

Nr.	Monumenti Natyror	Nr.	Monumenti Natyror
1	Guri i Prere	15	Pisha e Shendellise
2	Guri i Capit	16	Rrepet e qytetit (Shenmeria)
3	Piramidat e Tokes se Zhombrit	17	Shparthi i Osojes-Bakullit
4	Bokerimat e Moglices	18	Pisha e Voskopoje
5	Ishulli i Malligradit	19	Pisha e Makrezes
6	Vareze fosilesh te kretes se poshteme (Lavdar)	20	Bredhi i burimit te Çardakut (Gurit i Capit)
7	Mosperputhje kendore e Polenes se Vjeter	21	Ahishtja e Protopapes Opar
8	Burim uji dhe gazi te djegshem ne thyerjen tektonike te Polenes	22	Bliri i Shen Pjetrit (Vithkuq)
9	Liqenet e Lenies	23	Plepi i Gjyrasit
10	Lisat e Shenthanasit	24	Pylli i perzjere i Maliqit
11	Rrobulli i Kuq	25	Ahishtet e Bofnjes
12	Zgavra e Zaverit (Prespe)	26	Venjat e Kallamasit
13	Dushqet e Manastirit (Djellas Prespe)	27	Rrobulli i Lenies
14	Venjat e Dishnices		

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



Rrethi i Zonave të Mbrojtura
Protected Areas Network

Korri/July
2014

- Emers Name
- 01 Lumi i Orshit
 - 02 Kallit
 - 03 Beshik i Drenovës
 - 04 Beshik i Hito-Ek Dangush
 - 05 Bureti
 - 06 Luginë e Kariçinës
 - 07 Luginë e Valbonës
 - 08 Lumi i Dajçit
 - 09 Lumi i Lirionit
 - 10 Lumi i Nartës
 - 11 Lumi i Rrethit
 - 12 Prizri
 - 13 Lumi i Shkumbin
 - 14 Sheshk i Jadrakës
 - 15 Tërpi
 - 16 Zë e Dujës
 - 17 Beshik i Shkollës
 - 18 Kallit
 - 19 Mali i Gjalit
 - 20 Mali i Hapës
 - 21 Lumi i Fshatit
 - 22 Ymiri
 - 23 Zë
 - 24 Rrafshi
 - 25 Bregu i
 - 26 Bogova
 - 27 Bregu i
 - 28 Gjiri i Krujë
 - 29 Karaburur
 - 30 Kallit
 - 31 Lumi i Van Tale
 - 32 Kallit
 - 33 Lumi i
 - 34 Lumi i Shkollës
 - 35 Parku Fushë Krujë
 - 36 Parku Fushë Krujë
 - 37 Parku
 - 38 Parku Bushi
 - 39 Parku
 - 40 Kallit
 - 41 Sheshk i Gjermës
 - 42 Lumi i
 - 43 Lumi i
 - 44 Fshat i Shtëpitë
 - 45 Mali i Grogë Bushi Matariç
 - 46 Lumi i Prizrit
 - 47 Lumi i Bunës Valpogë
 - 48 Parku
 - 49 Lumi i
 - 50 Beshik i Orshit
 - 51 Lumi i Nartës
 - 52 Lumi i
 - 53 Parku Shëtit
 - 54 Parku Shëtit
 - 55 Parku
 - 56 Lumi i Uçës
- Monument Natyral

- RAMBSAR SITE
- Emers Name
- R1. Fshat i Dujës
 - R2. Luginë e Kariçinës
 - R3. Lumi i Bunës dhe rrethorë
 - R4. Lumi i Uçës
 - R5. Parku Fushë Krujë
 - R6. Lumi i Prizrit
 - R7. Lumi i
 - R8. Lumi i
 - R9. Parku
 - R10. Parku
 - R11. Parku
 - R12. Parku
 - R13. Parku
 - R14. Parku
 - R15. Parku
 - R16. Parku
 - R17. Parku
 - R18. Parku
 - R19. Parku
 - R20. Parku
 - R21. Parku
 - R22. Parku
 - R23. Parku
 - R24. Parku
 - R25. Parku
 - R26. Parku
 - R27. Parku
 - R28. Parku
 - R29. Parku
 - R30. Parku
 - R31. Parku
 - R32. Parku
 - R33. Parku
 - R34. Parku
 - R35. Parku
 - R36. Parku
 - R37. Parku
 - R38. Parku
 - R39. Parku
 - R40. Parku
 - R41. Parku
 - R42. Parku
 - R43. Parku
 - R44. Parku
 - R45. Parku
 - R46. Parku
 - R47. Parku
 - R48. Parku
 - R49. Parku
 - R50. Parku
 - R51. Parku
 - R52. Parku
 - R53. Parku
 - R54. Parku
 - R55. Parku
 - R56. Parku
 - R57. Parku
 - R58. Parku
 - R59. Parku
 - R60. Parku

- Shprehjet e
1. Parku Natyral
 2. Parku Natyral
 3. Parku Natyral
 4. Parku Natyral
 5. Parku Natyral
 6. Parku Natyral
 7. Parku Natyral
 8. Parku Natyral
 9. Parku Natyral
 10. Parku Natyral
 11. Parku Natyral
 12. Parku Natyral
 13. Parku Natyral
 14. Parku Natyral
 15. Parku Natyral
 16. Parku Natyral
 17. Parku Natyral
 18. Parku Natyral
 19. Parku Natyral
 20. Parku Natyral
 21. Parku Natyral
 22. Parku Natyral
 23. Parku Natyral
 24. Parku Natyral
 25. Parku Natyral
 26. Parku Natyral
 27. Parku Natyral
 28. Parku Natyral
 29. Parku Natyral
 30. Parku Natyral
 31. Parku Natyral
 32. Parku Natyral
 33. Parku Natyral
 34. Parku Natyral
 35. Parku Natyral
 36. Parku Natyral
 37. Parku Natyral
 38. Parku Natyral
 39. Parku Natyral
 40. Parku Natyral
 41. Parku Natyral
 42. Parku Natyral
 43. Parku Natyral
 44. Parku Natyral
 45. Parku Natyral
 46. Parku Natyral
 47. Parku Natyral
 48. Parku Natyral
 49. Parku Natyral
 50. Parku Natyral
 51. Parku Natyral
 52. Parku Natyral
 53. Parku Natyral
 54. Parku Natyral
 55. Parku Natyral
 56. Parku Natyral
 57. Parku Natyral
 58. Parku Natyral
 59. Parku Natyral
 60. Parku Natyral

Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura
Biodiversity and Protected Areas Directory



Monumentet e kulturës që mund të vizitohen në rrethin e Korçës janë:

- Kalaja e Mborjes në fshatin Mborje e ndërtuar mbi një kodër të lartë në afërsi të qytetit.
- Kalaja e Klocës në fshatin Klocë.
- Kalaja e Koçaçit në fshatin Koçaç.
- Kalaja e Symizës në fshatin Symizë.
- Kalaja në fshatin Podgori.
- Kalaja në fshatin Dishnicë.
- Kalaja në fshatin Kuç i Zi.
- Kalaja e Gobeshit në fshatin Moglicë.
- Kalaja e Gradishtës në fshatin Zerec.
- Vendbanimi prehistorik gjatë rrugës automobilistike në fshatin Vashtëmi.
- **Vendbanimi prehistorik në qytetin e Maliqit.** e tje.

Në qarkun e Korçës ka dhe mjaft objekti kulti të vizitueshme si:

- Manastiri i Shën Pjetrit dhe Kisha e Shën Kozmait (Qimitiri) në fshatin Vithkuq.
- Manastiri i Shën Prodhromit në fshatin Voskopojë.
- Kisha e Manastirit të Shën Marisë në fshatin Lubonjë.
- Kisha e Shën Thanasit në fshatin Voskopojë ka piktura te shek 18 te bera nga Kostandini i Beratit.
- Kisha e Shën Mëhillit në fshatin Voskopojë.
- **Kisha e Shën Kollit në fshatin Voskopojë.**
- Kisha e Shën Marisë në fshatin Voskopojë.
- Kisha e Shën Jovanit në fshatin Bobshticë mendohet te jet ndertuar ne shek e 13.
- Kisha e shën Mitrit në fshatin Bobshticë u ndertua dhe u pikturua ne shek e 17.
- Kisha e Ristozit në fshatin Mborje ka portretin e Jezuit duke hyr ne Jeruzalem. Mbishkrimet tregojnë se kisha ka qenë egzistente në 1389 dhe shumë gjëra tregojnë se është ndërtuar në 1300. m
- Xhamia e Iliaz Mirahorit në qytetin e korçës.
- Hani “Elbasani” në qytetin e Korçës.
- Hani “Manastiri” në qytetin e Korçës.
- Pazari i Vjetër i qytetit të Korçës.
- Katedralja e Shën Marisë (Muzeu Antik Mesjetar).
- Misafirhaja e Vangjush Mihos (studio) Rr. Shpresa Palla” Nr. 12 qyteti i Korçës.
- Shtëpia ku u ngrit Flamuri i Republikës së Korçës (Muzeu Historik).
- **Mësonjtorja** e parë shqipe në qytetin e Korçës (Muzeu i Arsimit Kombëtar).
- Shtëpia ku u krijua qarkor i partisë në qytetin e Korçës.
- Shtëpia e Themistokli Gërmenjit në qytetin e Korçës.
- Shtëpia e Mihal Gramenos në qytetin e Korçës.
- Shkolla e vjetër në fshatin Panarit ku më 1944 u përgatitën kuadrot e para të PPK.
- Shkolla në fshatin Kucakë ku ka qendruar Shtabi i Përgjithshëm dhe E. Hoxha.
- Shtëpia ku ka ndenjor shtabi i përgjithshëm në fshatin Vithkuq
- Monumenti i luftëtarit kombëtar në qytetin e Korçës.

· Monumenti i Themistokli Gërmenjit.

· **Tuma e Kamenicës**

Gjithashtu gjenden edhe shumë monumente natyre, shumë të bukura për t'u vizituar.



Pamje nga Ishulli i Maligradit

- Guri i Capit
- Piramidat e Tokës së Zhombrit
- Bokerimat e Moglicës
- Ishulli i Maligradit
- Varrezë fosilesh të kretes së poshtëme (Lavdar)
- Burim uji dhe gazi të djegshëm në thyerjen tektonike të Polenës
- Liqenet e Lenies
- Lisat e Shënthanasit
- Rrobulli i Kuq
- Zgavra e Zaverit (Prespë)
- **Dushqet e Manastirit (Djellas, Prespe).**
- Venjat e Dishnicës
- Pisha e Shendellise
- Rrepet e qytetit (Shënmëria)
- Shparthi i Osojes-Bakullit
- Pisha e Voskopojës
- Pisha e Makrezes
- Bredhi i Burimit të Çardakut (Guri i Capit)
- Ahishtja e Protopapes Opar
- Bliri i Shën Pjetrit (Vithkuq)
- Plepi i Gjyrasit
- Ahishtet e Bofnjes
- Venjat e Kallamisit e tjerë.

Në këtë rreth, duke u mbështetur në kriteret e Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës (IUCN), janë shpallur edhe këto zona të mbrojtura si parqe kombëtare.

· **Bredhi i Drenovës** me sip. 1,380.0 ha, zonë e mbrojtur e kategorisë së II me VKM nr. 96, datë 21.11.1966

· **Prespa** me sip. 27,750.0 ha, zonë e mbrojtur e kategorisë së II me VKM nr. 80, datë 18.02.1999.

· **Krastafillak** – Pylli i përziejere i Maliqit me sip.250.0 ha, zonë e mbrojtur e kategorisë së IV me Urdhër MB, 1970

Informacion për cilësinë e ajrit dhe ujrave sipërfaqësore në zonën e veprimtarisë ku do të kryhen shkarkimet në mjedis. Një përshkrim i gjendjes dhe i vlerave egzistuese të mjedisit që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit të propozuar.

Të dhënat për Rrethin Korçë, Klima dhe natyra, Popullsia e aktiviteti ekonomik. Ajri, uji, faktorët klimatikë, zhurmat etj.

Pozita gjeografike: Qyteti i Korçës shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe është qendra e banuar më e madhe e pellgut me të njëjtin emër. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit, me gjërësi 16 km nga perëndimi në lindje dhe me gjatësi 35 km nga jugu në veri, dhe zë një sipërfaqe prej 300km². Korça ka një pozite të favorshme gjeografike pasi ndodhet në rrugët tregëtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47km) dhe Greqinë (35km).

Largësia fizike e rajonit të Korçës dhe nënrajoneve të tij kundrejt kryeqendrës ekonomike të Shqipërisë, Tiranës rezulton të jetë e ndryshme. Distancat luhaten nga 140 km prej Pogradecit, në 179 km nga Korça dhe 206 km e 223 km respektivisht nga Bilishtit dhe Erseka. Largësia mesatare e rajonit tonë prej Tiranës rezulton të jetë 187 km. Kurse largësia e rajonit të Korçës prej portit kryesor të vendit, atij të Durrësit, paraqitet në një distancë mesatare prej 215.8 km. Mesatarisht rajoni i Korçës ndodhet 201.3 km ose rreth 200 km larg prej megapolit ekonomik Durrës – Tiranë. Përparësitë kryesore janë sidomos për Pogradecin dhe Korçën me afërsi më të madhe dhe relativisht edhe për Bilishtin ku cilësia e infrastrukturës rrugore kushtëzon dhe kohëzgjatjes e përshkimit të saj. Ndërsa Kolonja dhe qendra e saj urbane Erseka paraqet një largësi më të madhe dhe njëherësh edhe një kohëzgjatje më të madhe prej Tiranës. Largësia fizike e qytetit të Korçës me kryeqendrën ekonomike të Shqipërisë, Tiranën, tradicionalisht ka qënë 179 km. Por transformimet ekonomike lokale e rajonale të viteve të fundit, sidomos në infrastrukturën rrugore, kanë bërë që distanca të ketë tendencën e shkurtimit të vazhdueshëm. Aktualisht Korça tenton të jetë më afër metropolit shqiptar. Shkurtimi fizik i rrugës Korçë – Tiranë është kryer së pari; nëpërmjet shndërrimit të saj në nivel superstrate në 64% të gjatësisë së saj, së dyti nëpërmjet eliminimit të kthesave të shumta pas rindërtimit të segmentit rrugor Librazhd – Qafë – Thanë, si pjesë prioritare e Korridorit VIII dhe të segmentit Korçë – Qafë Plloçë. Së treti, fillimi i punimeve në aksin e ri rrugor Qafë Plloçë – Qukës me gjatësi 40 km ul me 10.6 km distancën Tiranë – Korçë tashmë në 168 km. Gjithashtu ndërtimi i superstradës së re Tiranë – Elbasan prej 31.5 km, së bashku me dy tunelet prej 2.5 km të gjatë do të zvogëlojë edhe më tej distancën midis Korçës dhe kryeqytetit. Në këtë mënyrë rruga Korçë – Tiranë brenda vitit 2016 do të arrijë në rreth 145.5 km gjatësi. Nga ana tjetër ndërtimi i rrugës në parametra gjithnjë e më optimale sjell edhe në uljen e kohës së përshkimit të kësaj distance. Distanca Korçë – Tiranë mund të përshkohet normalisht për rreth 2 orë, prej të cilave 18 minuta do të jenë në stacionet Elbasan – Tiranë. Një kohëzgjatje e tillë përbën një përgjysmim kohor krahasuar me periudhën e para rindërtimit të fragmenteve rrugore të lartpërmendura. Përgjysmimi i kohës së komunikimit me Tiranën ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e sektorit terciar të ekonomisë dhe veçanërisht në degën e transportit në gjithë

Rajonin e Korçës. Kjo duket qartë në krijimin e lidhjeve të fuqishme midis tregut lokal e atij rajonal dhe megapolit prodhues e tregtar Tiranë – Durrës. Hapësira gjeografike e rajonit të Korçës tenton të jetë pjesë integrale e linjave të qarkullimit shqiptaro–ballkaniko–europian. Pozita gjeografike e tij duhet rivlerësuar në nivel kombëtar e më gjerë duke shfrytëzuar të gjitha përparësitë ekzistuese.

Pozita e Korçës në aspektin ndërkufitar Intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike dhe demografike ndërkufitare gjatë viteve të fundit e bën të nevojshëm trajtimin e pozitës së Korçës në raport me hapësirat gjeografike rreth saj, sidomos me ato kufitare.

Edhe në raport me këto hapësira, pozita gjeografike e Korçës është mjaft e përshtatshme. Rrethi i Korçës është në kontakt fizik të drejtpërdrejtë me zonat kufitare, në të cilat gjenden katër pika të rëndësishme doganore, në një distancë mesatare nga qyteti i Korçës prej 46,25 km. Vendkalimi kufitar më i afërt, ai i Kapshticës, gjendet 32 km larg Korçës, ndërsa më i largëti, ai i Qafë - Thanës, gjendet 61 km larg Korçës. Ekzistenca e marrëdhënieve të reja ekonomike ndërkufitare në të gjitha vendet e Evropës Juglindore si dhe tempi i ri që i ka përfshirë ato, kanë një rëndësi shumë të madhe. “Këto marrëdhënie mund të zgjidhin pjesërisht problemet që ndeshin bizneset në rajonet ndërkufitare që përfshijnë kërkesat e pakta në treg, nivelin e ulët të kapitalit dhe vështirësitë e eksportit dhe njëkohësisht ekziston një interes strategjik për nxitjen dhe zhvillimin e një tregu të madh rajonal i cili është i arritshëm”. Pikërisht të gjitha përparësitë e lartpërmendura, që i ofron pozita gjeografike e rajonit tonë, i mundësojnë atij dhe qytetit të Korçës një vendndodhje të privilegjuar krahasuar me gjithë qytetet e tjera të kësaj pjese të Ballkanit. Ky pozicion strategjik, në kontaktin e ndërprerjes së akseve të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, Maqedonisë, Bullgarisë dhe Greqisë, përputhet me qendrën e këtij tregu të madh rajonal. Përveç vlerës së kuadrit fizik, edhe lidhjet tradicionale sociale, ekonomike dhe demografike që vijnë nga historia, nuk e zbehin rëndësinë e kësaj pozite gjeografike. Niveli i popullimit ndërrajonal prej 763.875 banorësh, në hapësirën e kontaktit ndërkufitar, sjell një panoramë interesante. Popullsia e Rajonit të Korçës rezulton të jetë dominuese kundrejt popullsisë të dy rajoneve të tjera ndërkufitare me 361.914 banorë, ose 47.4% të popullsisë së këtyre rajoneve. Popullsia greke e Rajonit të Maqedonisë Perëndimore vjen e dyta me një numër prej 293.864 banorësh, që përbëjnë 38.5% të totalit. Ndërsa popullsia e rajonit Ohër – Resnjë, në FYROM prej 108.097 banorë është shumë më modeste krahasuar me popullsitë e rajoneve të tjera ndërkufitare shqiptaro – greke. Përkrahja specifike e kësaj popullsie arrin në 14.1% të popullsisë së përgjithshme ndërrajonale. Ndërsa qyteti i Korçës ka një popullsi banuese të përhershme prej 84.029 banorë, ndërkohë që në regjistrimin e popullsisë në vitin 2001 popullsia banuese e pranishme rezultoi në 55.130 banorë. Pavarësisht këtij ndryshimi kaq të madh të popullsisë të shkaktoar prej migrimit të fuqishëm në periudhën e tranzicionit, Korça përbën qytetin me popullsinë më të madhe ndër gjithë qytetet e lartpërmendura ndërkufitare. Ajo është mbi 3 herë më e madhe se popullsia e Follorinës (16.400 banorë) dhe ajo e Kosturit (17.038 banorë). Krahasuar me qytetet kufitare me Maqedoninë, Korça ka një popullsi më të madhe se Ohri, Struga dhe Resnja me 54.380, 36.892 dhe 16.825 banorë secila. Zhvillimi ekonomik i rajonit të Korçës në përgjithësi dhe qytetit të Korçës në veçanti kërkon domosdoshmërisht edhe ndryshimet aktuale të akseve rrugore. Dinamika e ekonomisë kombëtare dhe rajonale kushtëzon në funksion të hartimit të strategjive të zhvillimit ekonomik – social edhe procesin e identifikimit, planifikimit dhe krijimit të gjurmëve të reja rrugore. Një nga mundësitë është krijimi i një gjurme të re në nivel autostrade në linjën Kapshticë – Qaf Thanë.

Kushtet natyrore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e sektorit terciar.

Kuadri fizik i hapësirës gjeografike të rajonit të Korçës ka ndikimin e vet, në zhvillimin e sektorit terciar, jo vetëm me vendndodhjen gjeografike, por edhe me mjedisin fizik (kushtet natyrore) të hapësirës në

fjalë. Kushtet natyrore në tërësinë e tyre kushtëzojnë, por edhe ofrojnë mundësi zhvillimi për ekonominë në përgjithësi dhe për sektorin terciar si pjesë përbërëse e ekonomisë në veçanti. Elementet përbërëse të mjedisit gjeografik që kanë rolin e tyre në ecurinë e degëve të sektorit terciar janë ndërtimi gjeologjik, relievi, klima, hidrografia ose pasuria ujore dhe bota bimore dhe shtazore.

Ndërtimi gjeologjik, ka një vlerë jo të vogël në zhvillimin ekonomik të hapësirës gjeografike të marrë në studim. Në pamje të parë duket sikur ndërtimi gjeologjik dhe sektori terciar me natyrën e shërbimeve që ofron, janë mjaft larg njëri tjetrit, por nuk është kështu. Ndërtimi gjeologjik ndikon me kompleksitetin e vet mbi cilësinë e infrastrukturës rrugore në funksion të zhvillimit të tregtisë, transportit, ndërtimit, turizmit etj, madje edhe në ndotjet mjedisore urbane e rurale. Fortësia e shkëmbinjve dhe qëndrueshmëria tektonike e shtresave gjeologjike kushtëzon cilësinë dhe jetëgjatësinë e infrastrukturës turistike, ndërtimeve hoteliere, argëtuese, pistave të skive, rrugëve automobilistike dhe hekurudhore, tuneleve dhe aeroporteve ekzistuese dhe në të ardhmen.

Dinamika e lartë e evolucionit gjeotektonik e gjeoklimatik në rajonin e marrë në studim, pasqyrohet edhe prej ndikimit të fuqishëm të tektonikës. Struktura e vjetër rrudhosëse është prezente sidomos në pjesën perëndimore të rajonit me “rrudhat e lartreshqitjeve – mbihipjeve”.

Për secilën prej këtyre depresioneve të relievit kemi nga një “qendër graviteti”, me vendbanimet si Korça, Erseka, Leskoviku, Pogradeci e Bilishti për njësinë përkatëse. Përtej zhvillimit vertikal të proceseve natyrore e humane, fushëgropat e gropat nuk shprehin ndonjë izolim gjeografik. Përkundrazi komunikimi midis tyre ka qenë i qëndrueshëm. Megjithëse relievi malor është dominues, lidhja e pjesëve depresive me njëra – tjetrën realizohet prej qafave e grykave të shumta. Prania e tyre mundëson ekzistencën e një rrjeti rrugor që siguronte jo vetëm lidhjet e brendshme, por dhe komunikimin ndërrajonal.

Në lidhjet e brendshme Korça ka përbërë kryeqendrën e gjithë rajonit, madje “nga viti 1870, Korça u bë Prefekturë, duke patur në juridiksion Bilishtin, Kolonjën dhe Kosturin”. Jo rastësisht nëpër hapësirën e këtij rajoni kanë kaluar rrugë të rëndësishme tregtare ndërrajonale, si ajo që lidhte Manastirin me Korçën dhe Janinë.

Rajoni i Korçës ka një nivel të kënaqshëm të dendësisë së rrjetit rrugor me 0.71 km/km^2 , ose 1.5 herë më të madhe se mesatarja e vendit prej 0.48 km/km^2 . Shkallën më të lartë të dendësisë së rrjetit rrugor, madje nën mesataren rajonale e kanë rrethi i Devollit dhe i Kolonjës me përkatësisht 0.46 km/km^2 dhe 0.51 km/km^2 .

Indirekt kjo tregon shtrirjen më të vogël sipërfaqësore, prezencën e një raporti më pozitiv midis vendbanimeve në sipërfaqet fushore kundrejt atyre në sipërfaqe kodrinore e malore.

Karakterit malor i një sipërfaqe të konsiderueshme në rrethin e Korçës dhe kontrasti i thellë hipsometrik i pjesëve bregliqenore dhe relieveve malore që ngrihen pranë tyre në rrethin e Pogradecit janë shkaqet e një niveli të tillë të dendësisë së rrjetit rrugor. Niveli më i lartë i dendësisë së rrjetit rrugor në rajon i përket hapësirës urbane me një mesatare prej 5.1 km/km^2 . Ekziston një kontrast mjaft i thellë midis hapësirës urbane dhe asaj rurale, e cila ka një dedësi të rrjetit rrugor prej 0.56 km/km^2 .

Një dallim kaq cilësor është i natyrshëm për shkak të përqendrimit të lartë të popullatës në vendbanimet urbane, por edhe për shkak të ndryshimit të sipërfaqeve që këto hapësira zotërojnë. Qyteti me dendësinë më të madhe të rrjetit rrugor është ai i Korçës me 29.1 km/km^2 , ose 6 herë më të madhe se mesatarja urbane e rajonit. Pogradeci është qyteti i dytë më i madh dhe më i rëndësishëm i rajonit me dendësi të rrjetit rrugor prej 14.4 km/km^2 . Qytetet e Ersekës dhe Bilishtit ndërkohë kanë gati të njëjtën dendësi të rrjetit rrugor prej përkatësisht 2.9 km/km^2 dhe 2.8 km/km^2 . Por tendencat e urbanizimit të tyre janë diametralisht të kundërta; Erseka nga njëra anë vuan largimet e popullsisë së saj urbane dhe njëherësh thith një pjesë të vogël të popullsisë rurale të territoreve më periferike të rrethit, Bilishti përkundrazi me

një rritje migruese pozitive ka një tendencë të një rritje të shpejtë të popullsisë së tij dhe njëkohësisht edhe rritje të hapësirës së vet urbane. Në një nivel edhe më të ulët të dendësisë së rrjetit rrugor shfaqet qyteti i Maliqit me 0.95 km/km^2 dhe ai i Leskovikut me 0.24 km/km^2 .

Qyteti i Maliqit mund të themi se “vuan” pasojat e migrimit të popullsisë për shkak të transformimeve të mëdha ekonomiko – sociale të tranzicionit që kaloi vendi pas ndryshimeve politike të fillimit të '90-tës. Ndërsa qyteti i Leskovikut mund të hyjë në kategorinë e vendbanimeve të riskuara rëndë nga proceset e tranzicionit dhe prej pozicionit periferik e ndërkuftar edhe nga proceset e globalizimit. Nëse nga tërësia e rrjetit të vendbanimeve urbane do të hiqnim dy qytetet me dendësinë më të ulët të rrjetit rrugor (Bashkinë e Leskovikut dhe të Maliqit) atëherë diferencat midis kësaj dendësie në territoret urbane e rurale do të ishin edhe më të mëdha 18.6 me 0.56 km/km^2 , pra thjesht 33 herë. Ndërsa panorama e dendësisë së rrjetit rrugor lidhës mes vendbanimeve në hapësirën rurale prezanton një imazh tjetër. Dendësia mesatare e rrjetit rrugor për Rajonin e Korçës është 0.56 km/km^2 . Nivel më të ulët se mesatarja rajonale kanë rrethet e Devollit, Kolonjë e Korçës me përkatësisht 0.44 km/km^2 ; 0.5 km/km^2 dhe 0.52 km/km^2 . Vetëm rrethi i Pogradecit paraqet një nivel më të lartë se mesatarja e rajonit tonë me 0.83 km/km^2 . Ky tregues shfaq lidhje të ndryshme midis vendbanimeve dhe formave të relievit në rrethet e ndryshme të rajonit të Korçës. Në rrethin e Korçës shohim se dendësia më e madhe e rrjetit rrugor është kryesisht në komunat që shtrihen kryesisht në fushëgropën e Korçës, si komuna Pirg, Pojan me 1 km/km^2 dhe maksimumin e hasim në komunën e Libonikut me 1.6 km/km^2 . Niveli më i ulët i dendësisë së këtij rrjeti ndeshet në komunat Voskop, Vithkuq, Lekas, Qendër Bulgarec, Gorë, Liqenas, Voskopojë e Moglicë, me përkatësisht 0.24 km/km^2 ; 0.3 km/km^2 ; 0.36 km/km^2 ; 0.38 km/km^2 ; 0.42 km/km^2 ; 0.42 km/km^2 dhe 0.47 km/km^2 . Në këtë grup është interesant gërshetimi i komunave fushore e kodrinore si ajo e Voskopit dhe komuna Qendër Bulgarec ku dendësia e rrjetit rrugor është e ulët. Kjo ndodh për shkak të largësisë së vogël të vendbanimeve që, ose shtrihen në kodrat buzë fushës si në komunën e Voskopit, ose shtrihen përgjatë rrugëve kombëtare si në komunën Qendër Bulgarec. Ndërsa komunat e tjera dendësinë e ulët të rrjetit rrugor e kanë si rezultat i karakterit malor dhe periferisë që i karakterizon.

Në nivel të lartë të rrugëve të asfaltuara janë komuna Qendër Bulgarec dhe Voskop (Korçë) me respektivisht 31 km dhe 11.5 km ose 93.4% dhe 65.3% të totalit të fondit të tyre rrugor, si dhe komuna Qendër Bilisht nga 32 km gjithësej ka 22 km ose 68.8% të asfaltuara.

Në tërësinë e kësaj tabloje “gri” pozitivitet shfaqet ndërtimi i një rrjeti të ri rrugor të asfaltuar në tre destinacionet kryesore malore të rajonit, Voskopojë, Dardhë e Liqenas.

Parë në një fokusim më të lartë, relievi rajonal shpreh përshtatshmëri për zhvillimin normal të gjithë aktivitetit ekonomik e social të popullatës së Rajonit të Korçës. Hapësira e Rajonit të Korçës karakterizohet nga një originalitet i spikatur klimatik.

Klima është mesdhetare paramalore e malore sipas njësive përkatëse të relievit. Vera është e ngrohtë dhe e thatë duke qenë e lakmuar për banorët e pjesës bregdetare dhe Ultësirës Perëndimore të vendit. Kurse dimri është i ftohtë, i gjatë e me rreshje bore. Këto karakteristika kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë rajonale në përgjithësi dhe sektorit terciar në veçanti. Rajoni i Korçës prezanton një diapazon të gjerë të ndryshimit të vlerave termike. Kështu temperatura mesatare vjetore luhet nga 7.5°C dhe 8.3°C dhe 8.7°C në stacionet meteorologjike të Voskopojës, Dardhës e Vithkuqit, në vlerat maksimale të regjistruara në stacionet Pogradec e Leskovik me përkatësisht 11.6°C dhe 11.2°C secili. Vlera mesatare e temperaturës mesatare vjetore për gjithë rajonin në fjalë arrin në 9.8°C . Krahasuar me të, kontrastin më të fortë e kanë vlerat ekstreme të Voskopojës dhe Pogradecit, me një vlerë ndryshimi 2.3°C dhe 1.8°C secili. Nëse për stacionin e parë janë karakteri malor dhe hapja nga lindja faktorët që

kushtëzojnë edhe vlerat më të ulëta të këtij treguesi, për Pogradecin është ndikimi zbutës i liqenit të Ohrit ai që përcakton vlerat më të larta të temperaturës mesatare vjetore. Vlerat e temperaturës mesatare të janarit luhaten nga 2.1°C në Leskovik dhe Pogradec, në -1.9°C dhe -1.1°C respektivisht në Voskopojë e Dardhë të Korçës. Temperaturat minimale absolute, për gjithë rajonin në fjalë shprehen në vlera negative. Ato ndryshojnë nga -4.5°C për Pogradecin, në vlerën -26.8°C regjistruar në janar të 1987 në Sheqeras, e cila përbën edhe minimumin absolut të temperaturës për gjithë vendin. Në dallim nga vlerat termike që shfaqin stacionet meteorologjike në relievet e ulëta apo edhe atyre pranë vendbanimeve të ndryshme, në pjesët më malore vlerat e temperaturës janë edhe më të ulta, sepse përcaktohen nga shtrirja rajonale hipsometrike më e larta për gjithë vendin dhe nga kontinentaliteti i kushtëzuar prej largësisë maksimale prej rreth 100 km nga deti. Panorama e vlerave të temperaturës mesatare të korrikut për rajonin e Korçës prezanton gjithashtu një kontrast të fortë. Vlerat e këtij treguesi ndryshojnë me 4.4°C nga niveli më i ulët i regjistruar në Voskopojë me 16.4°C krahasuar me nivelin maksimal të regjistruar në stacionet e Leskovikut dhe Pogradecit me 20.8°C secili. Ky dallim është qartësisht i ndikuar prej pozicionit gjeografik dhe hipsometrik midis këtyre stacioneve. E njëjta situatë paraqitet edhe në analizën e vlerave të temperaturës maksimale absolute në nivel rajonal. Nivelet më të ulta prezantohen në zonat më malore si Dardhë, Voskopojë dhe Vithkuq me 34.2°C; 34.5°C dhe 36.0°C secili. Ndërsa vlera më e lartë e temperaturës maksimale absolute regjistrohet përsëri në stacionin e Pogradecit me 39.6°C. Krahasimi i amplitudave të vlerave ekstreme të temperaturës tregon qartë se rajoni i Korçës paraqet vlerat maksimale të këtij treguesi për gjithë vendin.

Dallimi i vlerave të këtij treguesi shpreh qartë edhe shtrirjen gjeografike të dukurisë në ndryshimin nga pjesët më të ulëta e perëndimore të rajonit tonë në stacionin e Leskovikut drejt ekstremiteteve më malore e njëherazi më lindore të rajonit dhe të gjithë vendit si stacionet Sheqeras, Zvirinë dhe Bilisht. Këto karakteristika termike kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë lokale në përgjithësi.

Kështu periudha e gjatë e dimrit, duke pasur parasysh edhe cilësinë e dobët të infrastrukturës rrugore rurale, krijon probleme për qarkullimin e njerëzve dhe të mallrave, veçanërisht në pjesët më malore e periferike të rajonit të Korçës. Ditët e akullta gjejnë maksimumin e tyre nacional pikërisht në Voskopojë me 131 ditë 112 me ngricë. Ngricat e ajrit kryesisht ajo e tokës ndikojnë në ecurinë e transportit. Procesi i ngrirjes së tokës 113 në thellësinë 10 cm, me koeficient sigurie 50%, fillon më 16 dhjetor dhe mbaron më 21 shkurt pra, me një gjatësi prej 67 ditësh.

Së bashku me këtë proces, **prania e rreshjeve** dhe trashësisë së borës, e bëjnë më komplekse ndikimin e klimës ndaj ecurisë së sektorit terciar të ekonomisë rajonale. Rajoni i Korçës paraqet gjithashtu origjinalitetin e vet klimatik edhe nëpërmjet elementit të rreshjeve. Kjo hapësirë përbën pjesën më të thatë nga ana pluviometrike për gjithë vendin, me rekordin prej 608.7 mm të regjistruar në stacionin e Sheqerasit. Nëse sasia mesatare shumëvjeçare vjetore e rreshjeve në rang vendi 114 është 1.480 mm, mesatarja rajonale shumëvjeçare vjetore e rreshjeve 115 prej 781.7 mm përbën gati gjysmën e saj. Shpërndarja gjeografike e sasisë shumëvjeçare vjetore të rreshjeve 116 është mjaft interesante. Nivelin më të lartë të këtij treguesi e hasim në pikat më perëndimore me 1109.1 mm të regjistruar në Leskovik, si dhe në pikat më malore të rajonit tonë me vlerat 1082.3 e 1012.5 mm mesatarja shumëvjeçare e regjistruar përkatësisht në Vithkuq dhe Dardhë. Në kontrast të thellë me të shohim nivelin më të ulët të mesatares shumëvjeçare të rreshjeve, i cili lokalizohet në pjesët qendrore e lindore të rajonit, me 608.7 mm; 618.3 mm të regjistruara në Sheqeras dhe Bilisht, si dhe vlerat 747.8 mm dhe 752.1 mm respektivisht për stacionet Pogradec e Korçë. Rreshjet e borës përbëjnë një dukuri të përvitshëm për rajonin e Korçës, i cili shfaqet nga muaji tetor deri në muajin maj. Numri i ditëve me rreshje bore si një mesatare rajonale arrin në 26.1 ditë. Ai luhetet nga 20 ditë për relievet depresive (18.7 ditë Pogradeci, 21; 21.4 e 25.5 ditë me

rreshje bore për Zvirinën, Liqenasin e Sheqerasin) në 29.3 ditë me rreshje për Ersekën në 31.3 ditë të tilla për Korçën e Bilishtin. Numri maksimal i ditëve me rreshje bore ndeshet në dy pikat më të spikatura për zhvillimin e turizmit në Voskopojë e Dardhë me 38.6 e 39.6 ditë. Për relievet e larta malore si në vargjet e Moravës, Malin e Thatë shohim një nivel edhe më të lartë prej 70 ditësh dhe në pikat më të larta malore e sidomos ato të vargut perëndimor në mbi 80 ditë. Fillimi e mbarimi i shtresës së borës në qytetin e Korçës ndodh në datat 3 dhjetor deri në 18 mars pra, për 105 ditë dhe për zonat malore, në Voskopojë, Dardhë nga 20 – 23 nëntori në 9 – 10 prill me një kohëzgjatje prej 141 ditësh. Trashësia e borës në pjesën fushore arrin në mbi 25 cm lartësi, kurse në zonat e tjera malore kjo trashësi arrin në mbi 50 cm dhe në kuotat më të larta shkon mbi 1 m lartësi.



Brenda një sfondi të tillë klimatik është e qartë se vështirësitë e dimrit për pjesën më të madhe të rajonit të Korçës janë përcaktuese në aktivitetin ekonomik. Më së shumti ndikimi klimatik mbi elementët përbërës të sektorit terciar si transporti dhe tregtia me bllokimin e rrugëve është negativ. Por për zhvillimin e turizmit dukuria e ditëve me rreshje bore, të shtresëzimit dhe kohëqëndrimit të saj, veçanërisht në pikat turistike malore dhe në pistat e skive në to, ky ndikim është pozitiv dhe madje kushtëzon edhe sezonalitetin turistik.

Klima

Korça ka klime mesdhetare kalimtare (ose klime mesdhetare kontinentale) me ndryshime të mëdha në temperaturë. Muaji më i nxehtë është gushti (25 °C) ndërsa muaji më i ftohtë është janari (2 °C). Mesatarisht gjatë vitit bien 710 mm rreshje të cilat minimumin e arrijnë në verë ndërsa maksimumin në dimër, duke e bërë Korçën një qytet përgjithësisht të thatë krahasuar me pjesën tjetër të Shqipërisë së lagësht. Temperaturat në Korçën që përthith 2300 orë rrezatimin diellor, përgjithësisht mbeten më të ulta se pjesa tjetër e Shqipërisë perëndimore, por më të larta se pjesa veri-perëndimore për shkak të lartësisë mesatare në rrafshin e Korçës. Megjithatë janë regjistruar raste kur temperatura ka arritur deri në 40 °C ose më tepër.

Korça - Temperatura dhe rreshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	4	7	8	14	19	24	28	29	22	17	10	6	Ø 15,7
Temp. Mini. (°C)	-3	-2	-1	4	9	12	14	15	11	7	3	-1	Ø 5,7
Reshje (mm)	58	89	51	53	99	25	18	10	51	81	132	53	Σ 720



Burimi: [Weatherbase: Moti në Korçë](#)

Potenciali hidrografik i Rajonit të Korçës është mjaft i lartë dhe njëherazi i rëndësishëm për ecurinë e sektorit të ekonomisë. Nëpër hapësirën gjeografike të saj shohim praninë e një rrjeti të pasur lumor. Dendësia mesatare e këtij rrjeti lumor është më e madhe se vlera mesatare nacionale prej 1.7 km/km^2 , duke aritur në rreth 2 km/km^2 . Ndër lumenjtë kryesorë mund të përmendim rrjedhjet e sipërme të lumenjve, Shkumbin, Osum dhe në cepin jug-perëndimor edhe disa afluentë të Vjosës, si lumi i Çarshovës dhe i Langaricës. Midis tyre veçohet rrjedha e lumit Devoll, që përshkon gati mepërme rajonin në një gjatësi prej 120.8 km. Një pasuri e jashtëzakonshme hidrografike për këtë rajon janë edhe dy prej liqeneve më të mëdha të vendit dhe gjithë Ballkanit, liqeni i Ohrit dhe i Prespës.

Origjina e tyre tektonike ka kushtëzuar pozicionimin hipsometrik të pasqyrave të tyre ujore nga 695 m mbi nivelin e detit të liqenit i Ohrit, në rreth 853 m të Prespës së Madhe e të Vogël. Liqeni i Ohrit me një sipërfaqe prej 362.6 km^2 është i dyti për nga madhësia në rang vendi dhe njëkohësisht regjistron edhe thellësinë më e madhe liqenore për gjithë Ballkanin prej 294 m.

Ndërsa liqeni i Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël regjistrojnë përkatësisht një sipërfaqe prej 285 km^2 dhe 44 km^2 dhe me një thellësi shumë modeste prej 35 m. Nga gjithë pasqyra liqenore e sistemit hidrologjik Ohër – Prespë prej 691.6 km^2 , pjesë e territorit shqiptar është vetëm 23.3% e tij ose 160.9 km^2 . Gjeosistemi Ohër – Prespë përbën një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit rajonal dhe më gjerë. Tejudukshmëria e ujërave liqenore e kushtëzuar prej furnizimit nëntokësor prej ujërave të liqenit të Prespës nga burimet karstike të Drilonit dhe Tushemishtit dhe fauna e veçantë me mbi 70% e

llojeve të peshqve endemikë dhe kolonive të vetme në Bashkimin Europian të shumimit të pelikanit (*Pelecanus crispus*, *Pelecanus onocrotalus*) në Prespë i japin mundësi zhvillimi sektorit terciar të ekonomisë me një gamë shumë të gjerë shërbimesh, veçanërisht ato të turizmit.

Shpella e Trenit buzë liqenit të Prespës së Vogël e pasur me vlera unikale të prehistorisë dhe veçoritë natyrore me stalagmitet e stalagmitet e shumta, liqenet në sallat e brendshme përbëjnë një nga destinacionet natyrore më të kërkuara sidomos prej speleologëve dhe vëzhguesve të specializuar të monumenteve natyrore.

Liqeni i Gjançit me sipërfaqe 129 0,4km² përbën një njësi të rëndësishme në hidrografinë e këtij rajoni. Përveç shfrytëzimit energjistik të ujërave të tij nëpërmjet hidrocentralit të Gjançit me kapacitet 130 modest prej 6-10 KW, brigjet e liqenit shfrytëzohen edhe për peshkim nga banorët vendas dhe vizitorët lokalë.

Përveç liqeneve tektonike në hapësirën e rajonit gjeografik të Korçës gjenden edhe liqenet akullnajore në vargjet perëndimore. Në shpatet e Gurit të Zi veçohet liqeni i Lukovës dhe liqeni i Madh, tre liqenet e Gurit të Topit, dhe në Valamarë – Lenie dominojnë ndër 10 liqenet akullnajore, liqeni i Zi dhe liqeni i Lenies të frekuentuar prej bukurisë mahnitëse natyrore kryesisht prej banorëve vendas e më gjerë.

Elementët e tjerë përbërës të mjedisit natyror si bimësia e tokat kanë ndikimin e tyre.

Bimësia dallohet për një shkallë të lartë të biodiversitetit e lokalizuar sidomos në dy vargjet malore që përshkojnë rajonin e Korçës, në perëndim dhe në lindje të depresioneve të relievit qendror. Në këtë hapësirë gjejmë prezencën e të gjitha kateve bimore. Megjithatë me një shtrirje mjaft të kufizuar prej 51.4 km² veçanërisht në luginat lumore në pjesën jugperëndimore të rajonit shohim katin e shkurreve mesdhetare.

Gjerësisht në gjithë rajonin e Korçës shohim praninë e katit të dushkut në brezin e tokave të kafenjta. Mbi tokat e murrme pyjore ngrihet kati i ahishteve dhe i halorëve me pyje të dendura në ngritjet më malore në vargjet lindore e perëndimore të zonës. Ndërsa mbi lartësinë 1600 m në tokat livadhore malore, gjejmë kullotat dhe livadhet alpine me një shumëllojshmëri të madhe barishtesh dhe lulësh.

Sipërfaqet e gjera pyjore me nivel të lartë të biodiversitetit janë shpallur në mbrojtje nga shteti.

Në kategorinë e rezervateve natyrore të menaxhuara nga 22 gjithsej në gjithë vendin 4 prej e tyre ndodhen në rajonin e Korçës: rezervati Krastafillak, Dardha, “Pylli i Fazanit” në Maliq, në rrethin e Korçës, rezervati Cangonj në rrethin e Devollit dhe rezervati i Shelegurit në Kolonjë. Ndër pesë peizazhet e mbrojtura në shkallë vendi në rajonin e Korçës janë shpallur dy të tilla: Pogradeci dhe Nikolica, ndërsa kategoria “zona të mbrojtura të resurseve të menaxhuara”, përfaqësohet prej Gurit të Nikës.

Këto hapësira për vetë bukurinë natyrore, burimet e shumta natyrore dhe peizazhin e veçantë piktoresk që ato paraqesin një potencial efektiv për zhvillimin e turizmit nga ai liqenor, malor, shëtitës, vizitonjës, rural e deri në atë aventurier. Aktualisht ekziston një fluks i qëndrueshëm vizitorësh ditorë gjatë gjithë vitit, kryesisht banorë vendas të rajonit dhe jashtë tij.

Mjedisi social-ekonomik

Popullsia

Sipas CENCUS 2011, popullsia e Shqipërisë është 2.8 milion banorë me një rënie prej 8% në dy dekadat e fundit. Gjatë periudhës 2001-2013, në Shqipëri, popullsia banuese është reduktuar në 10 qarqe dhe ka shënuar rritje vetëm në dy qarqe. Rënia e popullsisë përgjatë kësaj periudhe në të gjithë vendin ka qenë 8.2 për qind, por në Gjirokastrë popullsia ka rënë

me 35.7 për qind ndërsa në Tiranë është rritur me 26.1 për qind. Në vitin 2013, qarku me popullsinë më të vogël ishte Gjirokastra me afërsisht 68 mijë banorë ndërsa qarku me popullsinë më të madhe ishte Tirana me 766 mijë banorë.

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Bazuar në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe Proçedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit”, MM nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik ka realizuar projektin “Monitorimi i cilësisë së ajrit në qytetet kryesore të vendit tonë” si Tiranë, Durrës, Korçë dhe Vlorë për vitin 2013.

Veprimtaria studimore e monitoruese, është fokusuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Vlerësimi dhe studimi i treguesve mjedisorë të gjendjes dhe ndikimit në mjedis
- Realizimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LNP, PM10, NO₂, SO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX në stacione të përzgjedhura qëllimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të refl ektuara edhe në VKM nr 803, datë 4.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”. Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO₂, O₃ të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta kurse të dhënat e SO₂ regjistrohen çdo 5 minuta, d.m.th matjet realizohen 100% të kohës vjetore. Të dhënat e monitorimit për pluhurat (PM10 dhe PM2.5) realizohet orare .

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mesatare për treguesit e monitoruar

Tab. 1 Të dhënat mesatare vjetore

Nr	Stacionet	PM10 ug/m ³	PM2.5 ug/m ³	NO ₂ ug/m ³	O ₃ ug/m ³	SO ₂ ug/m ³
1	Tirana qender	33.5	17.8	41.6	49.4	-
2	ISHP	31.8	15.3	13	52.66	-
3	Vlore	34.37	16.11	7.25	75.25	-
4	Korce	27.52	-	5.06	66.2	5.83
5	Norma shqiptare	60	15	60	65	60
6	Standarti I BE	40	25	40	-	-


Situata për ndotjen nga PM₁₀ dhe PM_{2.5} . Pluhurat janë një nga ndotësit e ajrit që realisht shkaktojnë probleme serioze në shëndetin e njeriut.

Ndotja nga PM10 dhe PM 2.5 sipas OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron dhe 2.5 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkrive.

Kjo ndotje vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim janë kontribues në rritjen e PM10.

GRAFIKU 1

Vlera vjetore e PM10




Nga rezultatet e monitorimit të PM10 dhe PM2.5, siç vihet re dhe nga grafiku mesiperm, përmbajtja mesatare vjetore e PM10 nuk e tejkalon normën Shqiptare dhe standartin e BE në asnjë nga stacionet e monitoruara por problematik ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ku kemi tejkalim të ditëve që janë më të larta se norma ditore (Norma është 35 ditë të tejkaluara në vit).

Ndërsa përsa i përket PM_{2.5} mud të themi në të tre stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës vjetore të PM_{2.5} krahasuar me standartin vjetor Shqiptar në vlera të ulëta. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim prej afërsisht 10%, në stacionin e ISHP është afërsisht sa norma ndërsa në stacionin e poliklinikës qendrore kemi një tejkalim prej afërsisht 20%.

GRAFIKU 2

Vlerat vjetore te PM2.5




Kjo ndotje për PM₁₀ dhe PM_{2.5} vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve që lëvizin në rrugët me trafi k të rënduar, cilësia e lëndës djegëse, menaxhim joefi kas i trafi kut që shpie në dyndje dhe në kohë qëndrimi të gjatë si dhe mirëmbajtja e automjete.

Përmbajtja e ndotësave të gaztë (NO₂, SO₂)

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.

Në bazë të të dhënave të monitorimit, si duket dhe nga grafi ku i mëposhtëm ajri urban në përgjithësi rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë (SO₂ dhe NO₂), pasi në të gjithë stacionet e monitoruara vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të normës Shqiptare dhe standartit të BE përjashtim bën Tirana qendër ku kemi tejkalim të lehtë të standartit të BE. Kjo është e pritshme pasi burimi kryesor i ndotjes në zonën përreth stacionit është trafiku i automjeteve që të shumta janë në orët e mëngjesit dhe të mbasdites.

GRAFIKU 3
Vlera vjetore e NO₂



Ndotësit Fotokimik

Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësave primarë dhe përbërësve të tjerë të atmosferës. Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsiderueshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban.


Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës. Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

Në grafikët e mëposhtëm janë të dhënat vjetore në stacionin e Vlorës dhe Korçës krahasuar me normën vjetore Shqiptare ku shihet qartë se kemi një tejkalim të kësaj norme në të dy stacionet e monitoruara. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim në masën 16 % ndërsa në stacionin e Korçës kemi një kapërcim të ulët të kësaj norme.

Në grafi kun nr 5 kemi vlerat 8 orarëshe për periudhën në dy stacione të Poliklinikës qendrore dhe ISHP-së për periudhën Janar-Dhjetor 2013. Nivelet e larta të ozonit hasen në muajt e verës për efekt të rrezatimit më të fortë diellor.

GRAFIKU 4

Vlerat vjetore të O₃



Zhurmat

Nuk ka as monitorim te nivelit te zhurmave ne zonen ne vlersim, monitorimet jane kryer per disa pika te qyteteve kryesore duke qene se keto qytete kane ne disa pika te tyre trafik te renduar dhe zhvillime dinamike ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit. Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban dhe me problematike ne segmentet me me shume qarkullim dhe trafik te renduar. Kjo zone nuk vleresohet problematike persa i perket zhurmave.

Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2013, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

Problematika mjedisore në Rajonin e Korçës.

Shpesh peizazhet antropogjene në hapësirën gjeografike të marrë në studim vendosen në harmoni me mjedisin rrethues. Megjithatë presioni human mbi mjedisin paraqitet mjaft i fuqishëm, madje në disa raste edhe duke e dëmtuar atë.

Dëmtimet mjedisore me karakter natyror përgjithësisht janë shumë të rralla. Shembull mund të marrin erozionin, një dukuri mjaft e përhapur gati në të gjitha zonat malore që shtrihen në rajon, në zonën e Liqenasit, Gorë – Opar, Mokër, Kolonjë etj. Punimet publike si: rindërtimi i akseve të ndryshme rrugore, ujësjellësave, rrjetit të kanalizimeve nëntokësore në nivel kombëtar, apo edhe lokal, madje edhe brenda vendbanimeve urbane e rurale në pjesën dërrmuese të rasteve shoqërohet me dëmtime mjedisore.

Ndërhyrjet e njeriut paraqiten në shfrytëzimin e burimeve natyrore të përshtatshme për proceset ndërtuese si marrja e gurëve, çakullit, si dhe krijimi i ndotjeve të ajrit jashtë çdo lloj norme të lejuar, të dëmshme për kalimtarët apo edhe banorëve përreth.

Djegiet e sipërfaqeve pyjore dhe biocenozave të shumta në këto habitate përbën një nga dëmtimet më të rënda.

Dukuria e zjarreve tashmë është një realitet i përvitshëm. Zjarri përfshin pyjet në zonat më malore e periferike ku terreni i thyer më së shumti nuk është favorizues dhe infrastruktura rrugore është e dobët dhe zonat përgjithësisht janë të shpopuluara dhe me fshatra gati të braktisura. Një nga vitet më të vështira ka qënë veçanërisht vera e viti 2007, ku në gjithë rajonin e Korçës, u dogjën 3.800 ha 136 pyje, kullota e livadhe si në rrethin e Kolonjës në malin e Gërmenjtit, kreshta e Moravës në një sipërfaqe prej 90 ha në rrethin e Devollit.

Prerja e pemëve dhe shfrytëzimi i bimëve mjekësore sidomos i çajit të malit (Sideritis raeseri Boiss et Heldr) është një dëmtim tjetër mjaft i përhapur mjedisor. Prerja e drurëve bëhet për të siguruar lëndën e nevojshme djegëse për përdorim familjar. Por një pjesë e vogël individësh e shohin edhe si një mundësi për të siguruar të ardhura financiare.

FLORA DHE FAUNA

Rajoni i Korçës ku bën pjesë edhe Komuna Qendër Bulgarec, është i pasur persa i përket Florës dhe Faunës. Ka pyje të pasura pishë, bredhi, ah, murrizi, shelgu, plepi, lisi. Në zonat pyjore ka bimësi endemike shumë të pasur nga të cilat janë dhe bimët medicinale si: mëllaga e egër, zhumbriça, kamomili, kokrrat e dëllinjës së zezë, xinxifja, fjerguri, lulebasani e shumë lloje të tjera. Fauna gjithashtu është e pasur dhe përfaqësohet nga kafshë të tilla si: ujku, dhelpra, çakalli, ariu, lepuri etj. Zogjtë: fazani, thëllëza turtulli, pelikani, karabullaku etj. Peshqit: korani, krap, trofta, mërenga, ngjale, skobus, karras etj.

Biosfera, zonat e mbrojtura, pyjet janë përfaqësuesit kryesor të ekosistemeve natyrore ku jeton e zhvillohet pjesa më e madhe e bimëve natyrore drunore, shkurre, barishtore dhe kategoritë e tjera të florës spontane, si kërpudhat e shumëllojshme, myshqet, likenet, etj. Vlerat kryesore qëndrojnë tek llojet

drunore që për pyjet e komunës Drenovë janë ahu, dushqet, pisha e zezë, bredhi e më pak plepi i egër, bliri, mëshstekna, etj.

Vlera të spikatura kanë edhe shkurret si lajthia, dëllinjat, kulumbria, trëndafili i egër, murizi, etj, si edhe bimë të tilla si manaferra, luleshtrydhja, etj, të gjitha këto bimë me vlera industriale, mjekësore, ushqyese. Për nga origjina, pyjet janë dy llojesh, pyje natyrore dhe pyllëzime artificiale. Banorë të pyjeve janë edhe kafshët e pyllit. Fauna është e pasur, veçojmë këtu ariun e Bozdovecit, por përmendim edhe ujkun, dhelprën, lepurin e egër, derrin e egër, ketrin, etj. Edhe fauna që u takon rendeve, familjeve, klasave e gjinive të tjera është e pasur. Kullotat përfaqësojnë gjithashtu një veshje të rëndësishme të sipërfaqes, që lidhet ngushtësisht me aktivitetin njerëzor të blegtorisë

Dëmtimet mjedisore antropogjene gjenden me shumicë si kudo në gjithë vendin edhe pranë vendbanimeve të çdo rangu. Ato fillojnë me djegien pa kriter të mbeturinave dhe plehrave në pjesët e brendshme të banesave dhe më shpesh në vendgrumbullimin e tyre. Periferia e qytetit të Korçës dhe e komunave të saj është shumë e rrezikuar nga ky fenomen që po shndërrohet në gangrenë mjedisore e gati edhe shëndetësore për banorët e këtyre pjesëve suburbane.

Fillimi i ndërtimit të landfillit të planifikuar në zonën e periurbane të qytetit të Maliqit, do të shpinte në zgjedhjen përfundimtare për gati gjithë rajonin e Korçës.

Ekosistemet bregliqenore pranë liqeneve të Prespës dhe Ohrit, me vlera të jashtëzakonshme eko – turistike gjenden të kërcënuara prej hedhjes së mbeturinave jashtë vendgrumbullimit përkatës. Ambalazhet e produkteve ushqimore, shishet e qeset plastike, janë, si pranë sipërfaqes, ashtu edhe nën sipërfaqen ujore duke ulur vlerat turistike të këtyre zonave dhe shpesh janë edhe rrezik për shëndetin e fëmijëve dhe gjithë turistëve e banorëve të tjerë. Dëmtimi më i rëndë mjedisor, është transformimi i pjesës liqenore në Liqenin e Prespës së Vogël. Gjendja aktualisht ka precipituar në nivelin e një katastrofe të vërtetë ekologjike, ndoshta unikale në llojin e vet. Pjesa shqiptare e Liqenit të Prespës së Vogël është gati e kënetëzuar. Pasqyra liqenore është në 5 – 10 % të sipërfaqes ujore së këtij ekosistemi. Kjo ka ndodhur si rezultat i derdhjes sistematike për disa dekada të lumit Devoll mbi basenin ujor të Prespës. Qëllimi ishte përdorimi i kësaj mase ujore gjatë stinës së verës për ujitjen artificiale të sipërfaqeve bujqësore të fushëgropës së Korçës dhe Luginës së Devollit të Sipërm. Por aluvionet e shumta në ujërat e lumit Devoll në këtë sektor, kryen mbushjen sistematike të fundit të këtij liqeni. Përdorimi pa kriter i kullotjes shpeshherë ka çuar në zvogëlimin e vlerave ekologjike të kullotave e livadheve malore, por edhe krijimin e “shkaqeve” për zjarret e rëna në to. Gjithashtu në zonat me potenciale turistike si në Liqenas, Voskopojë, Vithkuq etj. zhvillimi i blegtorisë dhe kullotja e të imtave mund të shkaktojë edhe humbje të vlerave të mirëfillta të turizmit nga cilësia e peizazhit dhe deri tek ndotjet organike që ato krijojnë.

Në tërësinë e ndotjeve mjedisore nuk mund të lihen pa u përmendur edhe dëmtimet njerëzore të shkaktuara prej aktiviteteve minerale. Meqënëse rajoni i Korçës dallohet për pasuri të shumta minerale, shfrytëzimi i tyre në karrierë dhe në thellësi ka bërë që zonat përreth të kenë prishje të ekuilibrave natyrore. Dëmtimet hidrologjike janë të shumta, jo vetëm në zvogëlimin e rezervave nëntokësore e sipërfaqësore të ujit, por edhe në helmimin kimik nga ujërat acide të këtyre ujërave dhe përkeqësimin e cilësisë së tyre. Dinamika e proceseve minerare shkakton çlirimin e gazeve të dëmshme si CO₂, NO₂, SO₂, CO, etj, si dhe krijimin e pluhurave e tymrave të shumta që çojnë në ndotje mjaft të madhe të ajrit dhe atmosferës në përgjithësi. Ndonëse qyteti i Korçës është themeluar këto V-VI shekujt e fundit, zona e Korçës është një nga vendet e Evropës Jug-Lindore që është banuar më herët. Gërmimet kanë nxjerrë në dritë varre dhe fortifikime ilire.

Antikiteti

Zona e Korçës e ndodhur në kufi me Mbretërinë Ilire dhe Epirin është banuar që nga mijëvjeçari i katërt p.e.s. Epoka e Bakrit zgjati nga mijëvjeçari i tretë deri në mijëvjeçarin e dytë p.e.s. Deri në vitin 650 p.e.s. fushëgropa e Korçës udhëhiqej nga një dinasti e Mbretërisë ilire, ndërkohë pas vitit 650 u udhëhoq nga një dinasti Kaone. Gjatë kësaj periudhe zona banohej më së shumti nga fise Kaone dhe Molose. Gërmimet arkeologjike rreth qytetit të Korçës kanë zbuluar një arkivol të shekullit II e.s. i cili tregon të gdhendur figurën e dy farkëtarëve ilirë duke punuar hekurin në kudhër. Vlen të përmendet Tuma e Kamenicës Fakt që tregon banimin e kësaj zone në epoken e bakrit.

Mesjeta

Krahina e Korçës ra nën sundimin e perandorit bullgar Boriz në vitin 853. Ai formoi në këtë zonë njësinë administrative të emërtuar "Kutmicevicë", që në shqip do të thotë "Tokë e porsa pushtuar". Forcat bullgare qëndruan deri në vitin 1018.

Njoftimi më i hershëm i shkruar mbi ekzistencën e qytetit të Korçës vjen nga kronika mbi historinë dhe gjenealogjinë e familjes feudale shqiptare të Muzakajve, shkruar nga Gjon Muzaka me 1510. Shkruesi kur numëron zotërimet e Andre Muzakës I, i cili arriti titullin Sebastokrator më 1280-1281 dhe u bë zot i një krahine të gjerë që shtrihej në të gjithë Shqipërinë Qendrore deri në lumin Vjosë në jug, me kryeqendër Beratën dhe që përfshinte ndërmjet të tjerave Myzeqenë, Tomoricën, Oparin, Devollin, Kosturin, përmend dhe Korçën me emrin 'Kovica', të cilën e cilëson qytet. Nga fund i shekullit XIII e deri në prag të pushtimit osman, zona e Korçës u bë pjesë e Principatës së Muzakajve të cilët ishin me origjinë nga Opari.

Korça ka 51.152 banorë (në baze të regjistrimit të popullsisë 2011)

Ekonomia e qytetit të Korçës i ka themelet e saj në zhvillimin bujqësor, por nuk mund të lihen pa përmendur bizneset e mëdha të qytetit të cilat përfshijnë kryesisht sektorin e ndërtimit civil dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, sektorin ushqimor dhe atë të shërbimeve. Edhe pse Korça ofron mundësi të mira për zhvillimin e turizmit, ngelet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim. Niveli ekonomik i qytetit aktualisht ndodhet në një rritje kostante edhe pse duhet të sigurohet akoma stabiliteti ekonomik sipas standarteve të BE-së.

Turizmi në këtë qytet ka dy pika të rëndësishme e të frekuentuara shpesh nga turistët, fshatrat Voskopoje e Dardha. Përveç klimes malore, me pyje të dendur me pisha e bredha, dhe prezencën e një peisazhi mbreselenes, turistët mund të gjejnë pjese nga historia dhe trashëgimia e popullit shqiptar duke filluar nga periudha e sundimit Bizantin. Në Voskopoje gjenden një numër i konsiderueshëm kishash ortodokse dhe manastiresh që i perkasin kësaj periudhe. Gjate dimrit të dy këto fshatra turistike ofrojnë pista skijimi për vizitorët e tyre.

Zhvillimi i punimeve minerare në karrierë dhe nëntokë sjell degradimin e tokave bujqësore, të pyjeve e kullotave. Ato shoqërohen nga njëra anë me uljen e pjellorisë dhe nga ana tjetër me zvogëlimin e sipërfaqeve të tyre.

Hedhja e sterileve minerare shpeshherë krijon peizazhet e dampave minerare, të cilat kanë cilësinë më të ulët të peizazhit në zhvillimin e turizmit. Së fundi, në të gjithë shtrirjen gjeografike të rajonit të Korçës ashtu si në gjithë vendin, gjatë periudhës së diktaturës u ndërtuan një numër shumë i madh pikash dhe objektësh ushtarake. Përhapja mjaft e gjerë e tyre ka kushtëzuar dëmtimin e mjedisit, bile duke krijuar edhe një peizazh tepër zhgënjyes. Ekzistenca e magazinave, tuneleve, bunkerëve dhe pikave ushtarake të

mbushura me material ushtarak krijon një rrezik potencial, jo vetëm për zonat me vlera të larta turistike si në Voskopojë, Vithkuq, Moravë, Prespë e gjithandej, por edhe për çdo lloj vendbanimi.

Sensibiliteti i komunitetit por edhe pushteti vendor duhet të jenë në një nivel më të lartë për të shmangur rreziqet natyrore e humane dhe njëherazi për të rritur shkallën e shfrytëzimit të kësaj hapësire gjeografike në funksion të zhvillimit cilësor të sektorit terciar të ekonomisë.

Shkalla më e lartë e përqendrimit të popullsisë së rajonit të Korçës gjendet pikërisht në vendbanimet urbane të çdo rrethi përkatës. Qyteti i Korces me 5.492 banorë/km². Krahasuar me qytetet e lartpërmendura, popullsia e qyteteve të Bilishtit dhe Ersekës gjenden në një nivel më të ulët të dendësisë urbane me përkatësisht 2419.7 e 1680.8 banorë/km². Lëvizja e lirë e njerëzve pas fillimit të proceseve demokratike ka çuar në një migrim të fuqishëm nga zonat rurale më periferike e malore drejt vendbanimeve urbane të çdo rrethi, por edhe sipas madhësisë rajonale e kombëtare e më tej jashtë vendit. Nivelin më të ulët të përqendrimit të popullsisë e gjejmë në qytetet e Maliqit 62.2 banorë/km². Në këtë rast falimentimi i ekonomisë së centralizuar dhe objekteve industrialë në to shkaktoi jo vetëm largimin e fuqishëm të popullatës, por gati edhe humbjen e tipareve urbane të funksionimit të këtyre vendbanimeve. Ndërsa hapësira rurale në gjithë rajonin prezanton një kontrast të thellë në dendësinë e popullsisë midis hapësirave fushore e atyre kodrinoro – malore. Në komunat me shtrirje në relievet fushore shohim një dendësi të lartë të popullsisë. Në rrethin e Korçës ky tregues varion nga 157.7 banorë/km² në **Komunën** rrafshin e Korçës. Megjithatë janë regjistruar raste kur temperatura ka arritur deri në 40°C ose më tepër.

Shkarkimet si pasojë e transportit.

Nga vitet 1990 deri me sot janë shtuar shumë levizjet nepermjet transportit sidomos atij privat. Mbizoterues është transporti rrugor qe sipas statistikave pritet te dyfishohet deri ne vitin 2015. Shkarkimet si pasojë e transportit lidhen me disa probleme qe kane te bejne me cilesine e karburantit qe perdoret ne motorrat e automjeteve, numrin gjithmone ne rritje te automjeteve, moshen dhe fuqine motorrike te automjeteve, mirembajtja e tyre e tje.

Cilësia e ajrit.

Me aktivitetin e kryer, pavarësisht se nga subjekti janë marrë masa për vendosjen e sitemeve të kapjes së pluhurave do të krijohen probleme nga gazrat që lëshojnë jo vetem oxhaku por dhe makinat që do të qarkullojnë, por kjo nuk do te prishë cilësinë e ajrit deri në atë masë sa ai të jetë i dëmshëm për bujqësinë dhe shëndetin e komunitetit.

Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia

Gjeologjia

Kuadri fizik i hapësirës gjeografike të rajonit të Korçës ka ndikimin e vet, në zhvillimin e sektorit terciar, jo vetëm me vendndodhjen gjeografike por edhe me mjedisin fizik (kushtet natyrore) të hapësirës në fjalë. Kushtet natyrore në tërësinë e tyre kushtëzojnë, por edhe ofrojnë mundësi zhvillimi për ekonominë në përgjithësi dhe për sektorin terciar si pjesë përbërëse e ekonomisë në veçanti.

Ndërtimi gjeologjik, ka një vlerë jo të vogël në zhvillimin ekonomik të hapësirës gjeografike të marrë në studim. Në pamje të parë duket sikur ndërtimi gjeologjik dhe sektori terciar me natyrën e shërbimeve që ofron, janë mjaft larg njëri tjetrit, por nuk është kështu. Ndërtimi gjeologjik ndikon me kompleksitetin e vet mbi cilësinë e infrastrukturës rrugore në funksion të zhvillimit të tregtisë, transportit, ndërtimit, turizmit etj, madje edhe në **ndotjet mjedisore urbane e rurale**. Fortësia e shkëmbinjve dhe qëndrueshmëria tektonike e shtresave gjeologjike kushtëzon cilësinë dhe jetëgjatësinë e infrastrukturës turistike, ndërtimeve hoteliere, argëtuese, pistave të skive, rrugëve automobilistike dhe hekurudhore,

tuneleve dhe aeroportëve ekzistuese dhe në të ardhmen, si dhe siguron qëndrueshmërinë e objekteve sidomos atyre me lartësi të madhe.

Rajoni gjeografik i Korçës, si pjesë përbërëse e nënnjësisë jugore të Krahinës Malore Qëndrore, dallohet për një ndërtim gjeologjik të larmishëm. Kjo hapësirë në pjesën më të madhe të saj është pjesë e zonës tektonike Mirditë-Korab si dhe pjesërisht e zonës tektonike të Krastës dhe Krujës në pjesën Jug Perëndimore të saj. Dinamika e lartë e evolucionit gjeotektonik e gjeoklimatik në rajonin e marrë në studim, pasqyrohet edhe prej ndikimit të fuqishëm të tektonikës. Struktura e vjetër rrudhosëse është prezente sidomos në pjesën perëndimore të rajonit me "rrudhat e lartrëshqitjeve e mbihipjeve". Ajo zëvendësohet e rimodelohet në pjesët qëndrore dhe lindore të përfshira nga thyerje të fuqishme tektonike nga struktura shkëputëse e tipit horstgraben me moshë pliokuaternare.

Formacionet shkëmbore në këtë hapësirë dominohen prej shkëmbinjve sedimentarë që zenë gati 3/4 e territorit. Më shumë se 80% e tyre përfaqësohen prej terrigjenëve, ku hyjnë reshpet paleozoike depozitimet flishore JCr (sidomos në cepin juglindor dhe jugperëndimore të rajonit) me reliev mjaft të copëzuar dhe depozitimet molasike (Pg -N) në zonat depresive në aksin qëndror të rajonit, të ndara në molasat e gropave më të vjetra të Mokrës dhe e Librazhdit të ndikuara nga lëvizjet tektonike (paratortoniane) dhe në molasat e gropave më të reja Kolonjë, Korçë, Ohër, Prespë, Përrenjas të përfshira prej lëvizjeve neotektonike në pliocen e kuaternar, me tendencë të fuqishme zhytëse të tipit fushëgropë si ajo e Korçës, Pogradecit, Përrenjasit dhe me tendencë ulëse dhe më pas ngritëse si gropa e Kolonjës, Prespës, Çërravës e pjesës jugore të luginës e Devollit. Këto formacionet zenë mbi 65 % e territorit.

Karbonatikët përfaqësohen prej gëlqerorëve. Ata zenë pjesën tjetër prej 20% të shkëmbinjve sedimentarëve në një shtrirje prej rreth 25% të territorit. Gëlqerorët formojnë dy breza në pjesën lindore dhe perëndimore të rajonit në fjalë, në trajtën e vargjeve malorë, masivëve ose majave të shkëputura. Ato janë të dërmuara tektonikish dhe shpesh të karstifikuara.

Vend kryesor zë Horsti i Malit të Thatë në pjesën lindore të rajonit të Korçës dhe zgjatimet më jugore të malësisë së Rakickës dhe Llapishtit. Ato dominohen prej gëlqerorëve të triasit të sipërm, jurasit të poshtëm dhe më pak nga gëlqerorët e kretës Cr. Ndërsa në vargun perëndimor prezencja e gëlqerorëve paraqitet në mënyrë "pulsante", veçanërisht në kreshtat e maleve të Gurit të Zi, Gurit të Topit, Lenies. Në mënyrë lineare gëlqerorët shfaqen në kurrizet malorë që fillojnë me malet Ujë Bardhë -Gjanç dhe kulmojnë në pjesën më perëndimore në ngritjet më të fuqishme që fillojnë me malin e Bofjes e Ostrovicë e përfundojnë në malësinë e Rungajës.

Vlera e tyre ekonomike qëndron në praninë e rezervave të boksideve që presin të futen në qarkullim ekonomik e veçanërisht në shfrytëzimin e gurëve dekorativë për ndërtim dhe në shfrytëzimin e gëlqerorëve për prodhimin e gëlqeres. Zhvillimi intensiv i degës së ndërtimit në gjithë hapësirën gjeografike të rajonit të Korçës dhe nevojat që ajo ka për lëndët e para të materialeve ndërtimore i ka dhënë një rëndësi të dorës së parë këtyre shkëmbinjve gëlqerorë për prodhim çaklli, granili të dimensioneve të ndryshme, si dhe të gëlqeres.

Ndërsa shkëmbinjte sedimentarë të Kretës (Cr) me moshë më të re shtrihen në zonën e Rehovë -Vithkuq - Voskopojë dhe përfaqësohen nga formime të shkëmbinjve konglomeratikë (copëzorë) me mbizotërim të magmatikëve e më pak të sedimentarëve. Nga vete përshkrimi ato deri tani nuk kanë patur interes praktik. Kreta e sipërme përfaqësohet nga ndërthurje të shtresave gëlqerore me ato konglomeratike dhe shpesh sidomos në pjesën e sipërme nga gëlqerorë po copëzorë. Karakteristikë e veçantë e tyre është se si copëtueshmëria ashtu edhe materiali çimentues nuk përbëhet nga lëndë karbonatike. Kjo ka bërë që ky material të sjellë një përdorim të gjerë jo vetëm si material ndërtimi, prodhimi gëlqereje por edhe si gur dekorativ.

Dallohet sidomos guri dekorativ i Polenës, aq i punueshëm me daltë, që ka zbukuruar me vepra arti të skalitura mjediset publike në çdo pjesë të Korçës, Polenës e më gjerë, si dhe mermeret e Vithkuqit, të vëna tashmë në shfrytëzim.

Formacionet shkëmbore me moshë më të re përfaqësohen nga formime molasike terigjene, duke filluar që nga Eoceni (Pg²) e Oligoceni (Pg3), Neogjeni (N) dhe Pliocen Kuaternari. Këto depozitime molasike kanë një histori të veçantë zhvillimi gjeologjik dhe marrin pjesë në ndërtimin e gropave të brendshme të Albanideve. Eoceni tek ne ka karakter konglomeratik me zaje kryesisht karbonatikë e më pak magmatikë por çimentimi i tyre është vetëm karbonatik. Ndërsa në zonat e tjera ai është terigjen me pamje fliohidale (ranorë, alevrolite, argjila e më pak karbonate) dhe për vet përbërjen ai paraqet interes sidomos në zhvillimin e artizanatit.

Oligoceni (Pg3) me gjithë katet e nënkatet e tij përfaqësohet nga formime terigjene të formuara në ish detet e liqenet apo lagunat në lidhje të ngushtë me detin. Këto formime janë baza e vendburimeve të lëndëve energjitike, si qymyrguri në Mborje -Drenovë, Boboshticë, Mal i Kuq dhe Babien, Qenckë, Lozhan, Selcë, Mesmal në zonën e Gorrës, që shtrihen deri në Pogradec. Sot nxjerrja e qymyrgurit është minimizuar dhe shfrytëzimi i tyre përcaktohet prej kërkesës së tregut lokal e më gjerë.

Neoceni nuk na ka falur ndonjë lëndë të parë minerale apo energjitike por me zhvillimet e sotme të ekonomisë së tregut ai mund të rifutet në qarkullim sidomos për përdorim si gur dekorativ. Të gjitha kollonat, trotualet, përmendoret që ka përdorur qytetari i vjetër korçar janë prej këtij materiali. Formimet më të reja sedimentare që marrin pjesë në ndërtimin e kësaj treve janë ato të Pliocen Kuaternarit (N2 P1). Këto ndërtojnë pothuase gjithë fushën e Korçës dhe kanë një përbërje terrigjene me një ndërthurje rërash, zhuri, zhavorre, argjili e rrallë konglomerate. Këto depozitime liqenore-kënetore, fundi i të cilave ka qënë ish kënetat e Maliqit, përbëhen nga disa shtresa qymyri në thellësi e torfat në sipërfaqe.

Pjesa tjetër e ndërtimit gjeologjik ose 1/4 e territorit zihet prej shkëmbinjve magmatikë. Ata përfaqësohen kryesisht prej intruzivëve të dominuar prej ultrabazikëve dhe më pak bazikëve, si dhe prej efuzivëve. Magmatikët shtrihen në rreth 10% të territorit. Gjeografikisht shtrihen në malësitë e Voskopojës dhe Vithkuqit, në malin e Valamarës, në Gorë, Mal i Zi në Rehovë, në Masivin e Devollit në Moglicë, si dhe në vargun perëndimor të Moravës.

Kjo përbërje gjeologjike ndikon në cilësinë e peizazhit duke kushtëzuar edhe vlerat turistike të hapësirave të caktuara, si dhe në zhvillimin e tregtisë e transportit me cilësinë e rrugëve, përgjithësisht të karakterit rural. Gjithashtu ato kanë vlera për të ardhmen për shfrytëzimin e alumino kromiteve, platinoidet etj.

Ndikimet e veprimtarisë së shfrytëzimit të objektit sipas fazave të ushtrimit të veprimtarisë.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

- **Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)**
- Vleresimi i ndikimeve në mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:
 - Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
 - Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
 - Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
 - Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
 - Parimi i qasjes së integruar
 - Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
 - Parimi "Ndotësi paguan"

- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per cdo banor te Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

(Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit)

Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te larjes se ambjenteve te brendeshme te spitalit, nga larja me solucione e eneve te perdorura ne laborator, si edhe sterilizimi i pajisjeve dhe mjeteve te punes. Gjithashtu, ujerat qe perbejne pjesen me te madhe sasiore jane ujerat sanitare te aktivitetit human te spitalit. Keto ujera shkarkohen ne sistemin e brendshem te kanalizimeve te spitalit, ku grumbullohen ne nje kolektor kryesor i cili sherben edhe si dekantues i ketyre ujerave. Me pas keto ujera shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te qytetit.

Objekti eshte i pajisur me sistem kanalizimesh si ne terrenet e jashtem edhe ne sistemin e objektit. Ujerat e shiut nuk perzihen me ato sanitare. Nuk ka problem permbytjeje, ujerat kane sistem kullimi te mire projektuar.

Per zonen urbane kryesore, trajtimi i ujerave urbane do te realizohet sipas skemes konvencionale te trajtimit te ujerave urbane.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer jane te pakta sepse si lende djegese ne kaldaja perdoren peletat e drurit. Kaldajat(5 cope) perdoren per prodhimin e avullit dhe funksionimin e sistemit ngrohes te ndertesave, me qellim per te arritur temperaturen e kerkuar sipas ambjentit.. Duke qene se perdoren lendet djegese ne procesin e prodhimit te avullit per ngrohje , keto te fundit shoqerohen me çlirime ne ajer te gazeve ndotes per mjedisin, te tilla si: CO, CO₂, NO_x, SO_x. Keto gaze bejne pjese tek grupi i gazeve “Greenhouse Gases”, te cilat kontribuojne ne efektin “serre” dhe si rrjedhoje edhe ne ndryshimet klimatike. Eshte e

rendesishme te theksojme se keto gaze, çlirohen ne sasira teper te vogla dhe do te monitorohen gjate aktivitetit te kaldajes.

Zhurma dhe vibrime Ne pegjithesi nuk krijohen zhurma . Vlen per tu theksuar se gjeneratori i cili mund te jete burim zhurmash sepse eshte ne permasa dhe kapacitet relativisht te madh, ndodhet ne ne objekt te mbyllur (brenda kaldajes dhe nuk emetohet zhurma jasht objektit) por ai ndizet shume rralle, vetem kur ka shkeputje te energjise elektrike nga rrjeti dhe kur kjo shkeputje ndodh, ai vetendizet nepermjet nje sistemi automatik, duke mos lene asnje moment spitalin pa energji elektrike. Nuk do te shkaktohen vibrime.



Ndikimi ne toke

Proçeset e punes nuk ndikojne ne toke. Aktualisht, nuk demtohet me tej bimesia, nuk demtohet relievi as struktura e tokes, pasi nuk ka ndryshime ne instalim, as zgjerim te siperfaqes.

Ndikimi ne Biodiversitet

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e zones. Funksionimi i metejshem i ketij aktiviteti nuk ndikon ne biodiversitetin e kesaj zone.(vetem ne rast te shkarkimit te ujerave te ndotura do te duhej te behej nje vleresim i thelluar).

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete sherbimit qe ofrohet, i cili eshte i pa zevendesueshem, por edhe punesimit. Efekti negativ i aktivitetit eshte ne shkarkimin e gazeve te demshme te furres se kaldajes e cila funksionon me djegjen e peletes se drurit dhe shkarkimi i ujerave te ndotura urbane. Mbetjet spitalore duhet te menaxhohen nga nje subjekt i licensuar per menaxhimin e mbetjeve spitalore. Per te shmangur efektet, subjekti duhet te jete pajisur me vaske dekantuese, sistem trajtimi te ujit dhe filtra per oxhqet e kaldajave. Objekti nuk duhet te funksionoje ne nje zone te rrezikuar nga permbytjet, te rrezikuar nga zjarret (siç jane pyjet), nuk duhet te kete akses askush i paautorizuar dhe duhet te kete siguri fizike.

Mbetjet e ngurta të gjeneruara nga kjo veprimtari janë mbetjet spitalore dhe ato urbane. Mbetjet spitalore seleksionohen dhe ambalazhohen në kontenjerë të përshtatshëm për çdo lëndë përbërëse të tyre. Më tej ato evidentohen, regjistrohen dhe magazinohen në një ambient të përshtatur për mbajtjen e tyre deri në largimin përfundimtar(nje pjese e mbetjeve trajtohen ne autoklaven e spitait, ndersa pjese tjeter e mbetjeve te rrezikshme u jepet subjekteve te licensuaraper vitin 2016 kjo kontrate ka qene me subjektin "Euroteam"sh.p.k.

Mbetjet urbane qe zene nje volum rreth $2281,25m^3$ ne vit, largohen nga të gjitha ambientet e spitalit duke u hedhur/vendosur në kazanët e tyre(8 kazane nga te cilet 5 kazane me $1,1m^3$ dhe 3 kazane plastike prej $0,25m^3$ sejcili), të shpërndarë në pika të caktuara brenda teritorit të spitalit. Subjekti i kontraktuar nga Bashkia, evadon çdo ditë këto mbetje urbane dhe i dërgon ato në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane

të qytetit. Po çdo ditë bëhet pastrimi dhe dizinfektimi i vendit ku janë të vendosur këta kazanë të mbetjeve urbane.

Në V.K.M. Nr. 99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", përcaktohen lëndët përbërëse të mbetjeve spitalore dhe të atyre urbane.

18 MBETJE NGA KUJDESI SHËNDETËSOR NJERËZOR OSE SHITAZOR DHE KËRKIME QË LIDHEN ME TO (me përjashtim të mbetjeve të kuzhinave dhe restoranteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor).

18 01 Mbetjet nga kujdesi shëndetësor që nga lindja, diagnostikimi, trajtimi dhe/ose parandalimi i sëmundjeve në njerëzit.

18 01 01 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)

18 01 02 Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)

18 01 03 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet

18 01 04 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.)

18 01 06 Kimikate që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme

18 01 07 Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 01 06

18 01 08 Medikamente citostatika dhe citotoksike

18 01 09 Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08

18 02 01 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 02)

18 02 02 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet

18 02 03 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet

18 02 05 Kimikate që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme

18 02 06 Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 02 05

18 02 07 Medikamente citostatika dhe citotoksike

18 02 08 Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 07

20 MBETJET URBANE (MBETJET SHITËPIAKE DHE TREGTARE, MBETJE INDUSTRIALE E INSTITUCIONALE TË NGJASHME) PËRFSHIRË FRAKSIONET E Mbledhura VEÇMAS

20 01 Fraksionet e ndara (përveç 15 01)

20 01 01 Letër dhe karton

20 01 02 Qelq

20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat

20 01 10 Veshjet

20 01 11 Tekstilet

20 01 25 Vajra dhe dhjamna ushqimore

20 01 30 Detergjent të tjerë nga ato të përmendur në 20 01 29

20 01 36 Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35

20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37

- 20 01 39 Plastikët
- 20 01 40 Metalet
- 20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve
- 20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara
- 20 02 Mbetjet e kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave)
- 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme

Mbetjet spitalore seleksionohen që në burim duke u vendosur në kontenjerë plastikë

INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit në kushte normale funksionimi do të zgjase për aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ndikimi në mjedis zgjat për aq ore sa funksionon aktiviteti në ditë dhe aq ditë sa ai funksionon në një vit.

SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi në mjedisin e zonës në kushte normale të punës, mund të përhapet në një distancë të ngushtë, me dhjetëra metra, kjo përse i përket ndikimit të zhurmës dhe ajrit, pasi ndikimi në ujëra nëse do të shkarkohet në mjediset ujore mbi vlerat e lejuara, do të shtrinte ndikimin e tij deri në disa km, ose dhjetra km. Ujërat e gjeneruar nga aktiviteti grumbullohen në një kolektor kryesor dhe pasi kalojnë në një dekantues shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zonës. Trajtimi i ujeve të ndotur, për këtë rast, duhet të kryhet për të gjithë qytetin si sistem trajtimi të ujeve të ndotura urbane.

REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet të kujdeset për një mjedis të pastër, të rregullt, të gjelbëruar, të sigurtë dhe të pajisur me sinjalistikën dhe posterat sensibilizues përkatës për kushtet teknike dhe për mjedisin. Mjedi i këtij aktiviteti është me funksion si kompleks spitalor dhe si i tillë, plotëson të gjitha kushtet e një mjedisi të jashtëm të rehabilituar, të gjelbëruar dhe të mirembajtur. Në rast të mbylljes së aktivitetit, mund të merret në konsideratë mundësia e rehabilitimit të plote të sipërfaqeve dhe kthimin e peizazhit në gjendjen e mëparshme. Për këtë çështje, nuk kemi marrë në konsideratë, pasi ky aktivitet do të funksionojë si i tillë dhe nuk ka projekte për zhvendosjen e tij në kompleks tjetër.



NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDERKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëm të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet çështja e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetin fqinje.

MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Te mirembahet dhe te funksionojë sistemi i kanalizimeve dhe i dekantimit te ujerave te ndotura urbane duke bere dizifektimin e tyre.
- Te menaxhohen ne menyre te integruar mbetjet e ngurta te rrezikshme. (Te rinovohen rregullisht kontratat dhe te mikqyret subjekti ne pergjegjesine e menaxhimit te tyre).
- Te ruhen kushte te larta higjenike ne objekte dhe te pajisen te gjithe koshat me etiketat e mbetjeve te rrezikshme.
- Te kete vazhdimisht mirembajtje te sistemit te kaldajave dhe te zbatohen kushtet teknike te eneve nen presion dhe te mbrojtjes ndaj zjarrit ne objekt. (Të bëhet kontrolli dhe shërbimi profilkatik i kaldajave, duke zbatuar kërkesat teknike, në manualin/pashaportat respektive të dhënë nga prodhuesit e këtyre pajisjeve dhe shfrytëzimi i tyre të bëhet nga personel i kualifikuar dhe me eksperiencën e duhur)
- Te mirembahet dhe te kolaudohet sistemi i hidranteve dhe i bombulave te mbrojtjes nga zjarri ne objekt. Te jene funksionale sistemet e alarmit te renies se zjarrit dhe daljet e emergjences.
- Depoja e ujit te jete gjithmone e mbushur dhe funksionale per hidrantet ne raste te nevojshme.
- Te kryhen rregullisht monitorimi i gazeve te kaldajave dhe ne rast te tejkalimit te normave te merren masat e nevojshme te reduktimit, si vendosja dhe mirembajtja e filtrave duke respektuar normat e percaktuara ne V.K.M. Nr. 435 datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë" dhe V.K.M. Nr. 177 datë 31.03.2005 "Mbi normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- Te zgjidhet lenda djegese per gjeneratorin dhe makinat (nen 1% sqfur), ne menyre qe te jene te kontrolluara gazet qe emetohen.

Hartoi

Studio "ADON" sht.p.k.

